

# AKTI I THEMELIMIT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “Fab Holding” Shpk

#### Neni 1

Shoqeria e emërtuar “Fab Holding” Shpk sot me daten 20.08.2020 është krijuar nga Ortaku i Vetem themelues :

Shoqeria “CMR Holding” shpk e regjistruar pranë Qendres Kombetare te Biznesit me daten 26.04.2013 me Nipt-in L31626501S dhe me seli ne Lagjen 14, Rruga ish Ndermarja e serave Shkozet Durres.

#### Neni 2

Selia e shoqërisë do të jetë në Lagjen 14, Rruga ish Ndermarja e serave, Pasuria 1/580/ND vol.28, faqe 45, Zona Kadastrale 8515, Shkozet Durres. Me vendim të Ortakut te Vetem mund të hapen seli sekondare, filiale apo forma të tjera shoqërishe, brënda dhe jashtë teritorit të Shqipërisë.

#### Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat dhe do të fillojë nga momenti i regjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Biznesit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve me ligj ose kur vendos Ortaku i Vetem.

#### Neni 4

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj: Import eksport. Dhenie me qera te objekteve; Tregeti me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit; tregeti me shumice e pakice te artikuj industriale, ushqimore, bujqesore dhe blektorale; tregeti makineri e paisje, artikuj konsumi, hapje dyqane e lokale per restaurante e bar bufe, hoteleri; transport tokesor dhe detar, mallrash dhe udhetaresh brenda dhe jashte vendit.

#### Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 115.071.540 leke, perbehet nga 1 (nje) kuote dhe i formuar në masën 100 % nga kontributi i Ortakut Themelues “Fab Holding” Shpk.

Ky kapital perbehet nga kontributi ne natyre prona te patundeshme te vendosura nga organi vendimarrës i Ortakut themelues per ti kaluar ne shoqerine “Fab Holding” Shpk te cilat konsistojne ne:



Çertifikata	Data	Zyra e regjistrimit	Zona Kadastrale	Numri i Pasurisë	Volumi	Faqe	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja	Vlera kontabël
2085321	15.07.2020	Durres	8515	1/826	38	125	Truall	880	13,233,083
2085322	15.07.2020	Durres	8515	1/827	38	126	Truall	450	6,766,917
986060	11.02.2015	Durres	8515	1/592	28	49	Truall	1254	7,526,000
2053439	11.03.2020	Durres	8515	1/818	38	44	Truall +ndertese	1082	17,452,225
1731080	31.05.2018	Durres	8515	1/513-ND	26	27	ND (kapanon)	1000	432,874
1983345	09.10.2019	Durres	8515	1/584	28	42	Truall	1161.4	17,000,000
1927007	20.08.2019	Durres	8515	1/588	28	60	Truall	703	1,210,700
1927001	20.08.2019	Durres	8515	1/578/ND	28	43	ND (kapanon)	930	9,183,342
1927002	20.08.2019	Durres	8515	1/579/ND	28	44	ND (kapanon)	893	4,600,660
1927003	20.08.2019	Durres	8515	1/580/ND	28	45	ND (kapanon)	553	8,474,900
2083383	17.08.2020	Durres	8515	1/585	28	57	Truall	993	10,519,540
2083384	17.08.2020	Durres	8515	1/586	28	58	Truall	893	11,697,540
2083385	17.08.2020	Durres	8515	1/587	28	59	Truall	592	6,973,760
Totali									<b>115,071,540</b>

Neni 6

Për nevoja të punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të çelë llogari në çdo bankë të njohur me ligj si dhe të punesoje puntore e specialiste të ndryshem me kontrate të rregullt pune sipas ligjeve në fuqi.

Neni 7

Administrator i shoqërisë është Ahmet Bajrami .

Neni 8

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij akti edhe me norma të përcaktuara në statutin e saj. Akti i themelimit u përpilua në 4 kopje për tu administruar sipas ligjit.

**Ortaku i Vetëm Themelues**

**Shoqëria "CMR Holding" Shpk**

Perfaqesuesi Ligjor

Ahmet Bajrami